



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Nr. 3168/4 Prot.

Vlorë më, 01.12.2025

VENDIM

Nr. 118 datë 05.12. 2025

PËR

**"PROPOZIM TË RRYTJES SË NIVELIT TË PAGAVE TË PERSONELIT
AKADEMIK TË UNIVERSITETIT " ISMAIL QEMALI" VLORE"**

Në mbështetje të nenit 38 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 19 të Statutit të UV-së Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar; VKM-së nr. 75, datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", i ndryshuar; VKM nr. 748, datë 11.6.2009, "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë", i ndryshuar me VKM Nr. 243, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në Vendimin Nr. 748, datë 11.06.2009", Udhëzimit të Përbashkët të MA dhe MFE nr. 20, datë 20.09.2019, "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", referuar relacionit të Drejtorisë së Shërbimeve Ndihmës-Akademike të UV-së me nr.3146, prot, datë 04.12.2025, Senati Akademik në mbledhjen e datës 05.12.2025,

VENDOSI:

1. T'i propozojë Bordit të Administrimit rritjen e pagave të personelit akademik të Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë në masën 8% mbi kufirin minimal të pagës (edhe 3% mbi 5% të rritjes që merret deri tani), sipas Lidhjes nr. 1 "Strukturat dhe nivelet e pagave për punonjësit e personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë" të VKM-së Nr. 243, datë 20.04.2023,
2. Burimi i financimit, të përballohet nga të ardhurat e realizuara nga Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë, prej pagesave të tarifave studentore për programet e studimit.
3. Bashkëlidhur relacioni i zëvendësrektorit akademik dhe efekti financiar për vitin buxhetor 2025.
4. Ky Vendim propozues i përcillet Bordit të Administrimit për miratim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

Prof. Dr. Aurela Saliaj

Adresa /Adress: Bulevardi Vlore-Skele
Tel. Fax ++355222288

Web-site: www.univlora.edu.al
e-mail: info@univlora.edu.al